

## AKT THEMELIMI DHE STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ E 7 ” SHPK

Ne Tirane, sot ne date 04 / 01/ 2024

*Bazuar në Kushtetuten e Rrepublikes Se Shqiperise , Kodit Civil ne fuqi , Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “ aktet ligjore e nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, në Tiranë, sot në datë 12/12./2021, shtetas:*

**Z: Arjan Coka** biri i Fore-s i datelindjes 07/06/1973 lindur ne Lac dhe banues ne Tirane , Lagjia Ali Demi pallati 129 H31 Ap 32, shtetas Shqiptar , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , identifikuar nepermjet kartes se identitetit me numer 036323379 dhe numer personal H30607060N

Krijon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “E 7 “ shpk

#### NENI 1 Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Tregtimi, import eksport me shumicë dhe pakicë të materialeve e pajisjeve elektrike, pajisjeve industriale e elektroshtëpiake, pajisjeve e sistemeve/impianeteve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji.

Import eksport mallra e pajisje te teknologjise ne fushen e energjitikes etj, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen, dhe menaxhimin e centraleve hidrike, impianeteve fotovoltaike e forma te tjera te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme.

Projektim dhe instalim i impianeteve e pajisjeve elektrike, elektroshtëpiake, industrial, sistemeve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme.

Projektme, zbatim projektesh, dhenie konsulence dhe asistence teknike, supervizim, punimesh, kolaudim impiantesh, mirembajtje ne fushen elektrike, elektronike, telekomunikacionit, radio televizionit dhe ne fusha te tjera te ngjashme, ne fushen e sistemeve hidraulike, termoteknike, impiantet e ndricimit, sinjalistikes rrugore etj

Projektim, instalim, operim dhe mirembajtje e sistemeve te prodhimit, prezantimit, transmetimit e monitorimit audio/vizual, TV, Radio, WEB-TV, IPTV, Hotel TV, Hospitality TV, A/V Conferencing, Analoge e Digjitale, Tokesoje, Satelitore, Kabllore, TCP-IP. \ Projektim, instalim, operim dhe mirembajtje e sistemeve te komunikimit WebConference, E-Publishing, E-Learnig, E-Comunication, VOIP, WEB Pages, DataBase, Digital Asset Management, Digital Logging, Monitoring e Analyzing etj.

Shërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshëm për materiale e pajisje elektrike, pajisje industrial e elektroshtëpiake si dhe për pajisje dhe sisteme të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe për

impiante të tjera të çfarëdo lloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme.

Shërbime konsulencë në lidhje me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake, pajisjet dhe sistemet/impianetet e ftohjes dhe të ngrohjes (kondicionimit), impianetet e tjera të çfarëdo lloji si dhe supervizionin në lidhje me instalimin e tyre.

Ndertimin dhe mirembajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndertimet e nenstacioneve, kabinat e transformatoreve linja TN e të mesem dhe shpërndarje të energjisë, rikonstruksionin e veprave të artit, montimet e konstruksionet metalike si dhe cdo ndertim tjetër që perben send të paluajtshëm në përfundim.

Shërbime konsulencë, mbikqyrje dhe kolaudimi lidhur me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake, pajisjet dhe sistemet/impianetet e ftohjes dhe të ngrohjes (kondicionimit), impianetet e prodhimit të energjisë elektrike, nga burime hidrike dhe të rinovueshme si dielli dhe era, impianetet e tjera të çfarëdo lloji si dhe supervizionin në lidhje me instalimin e tyre.

Testime, verifikime, kalibrime, riparime dhe mirembajtje për instrumenta matës dhe sisteme matës në fushën elektrike, elektronike, telekomunikacionit, radio televizionit, mekanike, hidraulike, në linja prodhimi të industrisë mjekësore dhe ndertimit. Verifikime fillestare dhe pasardhese të instrumentave matës ligjerisht të kontrolluar.

Ndertimin dhe mirembajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike, nga burime të rinovueshme si dielli dhe era. Realizim i impianteve fotovoltaike dhe eolike për gjenerimin e energjisë elektrike

Kryerjen me mënyrë dytesore të cdo veprimtarie tregtare që lidhet me përbushjen e objektit të saj tregtar dhe që konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme, duke përfshirë edhe zoterimin e kuotave ose pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera tregtare që ushtrojnë aktivitet të ngjashëm me aktivitetin e ushtruar nga vete Shoqëria si dhe ushtrimit të të gjitha të drejtave që lidhen me zoterimin e këtyre kuotave/pjesëmarrjeve. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me cdo person fizik apo juridik në cdo mënyrë që e gëjkon të dobishme.

Shoqëria në cdo kohë mund të ripercaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakesojë atë me vendim të asamblesë së përgjithshme.

## **NENI2** **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar. Vendosija e mëparshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

## **NENI3** **Selia**

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Skenderbej, Zona Industriale, jug, godina 28/1, ZK 8523 nr pasurie 33/25, Elbasan, Objekti 28/1 me sipërfaqe 86.1 m<sup>2</sup> dhe objekti 27/3 (I hapur) me sipërfaqe 188.16 m<sup>2</sup>

- Shoqeria e zhvillon veprimtarine duke hapur zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me misionin e shoqerise si dhe legjislacionit ne fuqi .

#### **NENI 4**

#### **Kapitali**

Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 ( njeqind mije ) leke i ndare ne 1( nje ) kuote vlera e te cilave zoterohet nga Ortaku si me poshte:

- **Arjan Coka 100%**

Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar. Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

#### **Neni 5**

#### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve,ajo mblidhet ne selin e saj apo ne cdo vend tjeter qe ndodhet Kryetari i asamblese.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhteme:

- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
- b) miratimi i ndryshimeve te statutit;
- c) emerimi e shkarkimi i anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre;
- d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;

- g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
  - h) pjesetimin e kuotave, anulimin e tyre, largimin e ortakut;
  - i) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem;
  - j) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
  - k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.
  - l) ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo statuti.
- Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur te drejten e votes ne raport me vleren nominale te kuotes se tij.
  - Çdo ortak mund te perfaqesohet ne vendimarrje nga nje ortak tjetër, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kushtin qe perfaqesuesit te jene te pajisur me autorizimin per ate qellim.
  - Administratoret e shoqerise nuk mund te jene perfaqesues te ortakeve ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve.
  - Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se ortakeve, por perfshin edhe mbledhjet me te njejtin rend dite.

Administratori(et) sipas gjykimit te tij te lire ose me kerkesen e nje dhe/ose me shume ortakeve te cilet perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise dhe/ose auditit ligjor nese ka, dhe/ose likuiduesit kane te drejte te therrasin Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve. Ne kete rast ortakeve duhet t'iu dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhjen me postë elektronike (email) jo me vonë se 7 dite perpara dates se mbledhjes, i cili thekson qellimin, vendin dhe oren e mbledhjes.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit brenda 6 muajve nga perfundimi i vitit ushtrimor.

Perveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% (tridhete perqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Per te vendosur shperndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, anulimin, fshirjen e kuotes, largimin e ortakut si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaqesuar ortakët qe zoterojne me shume se 50% (pesedhete perqind) te numrit total te votave. Vendimi merret me voten pro te te pakten 75% (shtatedhete e pese) perqind te ortakeve te pranishem.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorunit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri,por jo me vone se 30 (tridhjete) dite, me te njejtin rend dite.

### Neni 7

#### Administrimi i Shoqerise

Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Adminstratori.

Administratori emerohet me vendim te Ortakeve dhe qendron ne kete detyre per nje afat jo me te gjate se 5(pese)vjet.

Administratori mund te rizgjidhet per te njejten periudhe me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Administrator i Shoqerise do te jete: Z.Arjan Coka ,i biri i Fore-s , i datelindjes 07/06/1973 , shtetas shqiptar, lindur ne Lac dhe banues ne Tirane duke filluar nga data **04/01/2024**.

Administratori mund te shkarkohet me vendim te ortakeve ne çdo moment per arsye te justifikuara.

Administratori eshte personalisht pergjegjes perpara Shoqerise dhe/ose paleve te treta per deme te shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te Ligjit.

### Neni 8

#### Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit

Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqerise do te administrohen nga Administratori, i cili ka te drejte te ushtroje te gjitha kompetencat qe gjykon te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise.Administratori mundte autorizoj apo emeroje me ane te prokures persona te trete per kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave qe i perkasin Administratoreve.

Kompetencat e Administratorit ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise percaktohen por pa u kufizuar, si me poshte vijon.

- (a) Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
- (b) Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
- (c) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
- (d) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose te huaja;
- (e) Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise te cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

- (f) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
- (g) T'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te veçante per Shoqerine;
- (h) Te punesoje dhe te shkarkoje punonjes sipas politikave te shoqerise;
- (i) Te hartoje dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjetër qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorezohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ose autoriteteve te tjera.
- (j) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

### **Neni 9 Auditi Ligjor**

Auditi Ligjor do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese e legjislacionit shqiptar. Riemerimi do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Auditi Ligjor mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.

### **Neni 10 Viti Financiar**

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor .

### **Neni 11 Shperndarja dhe Prishja**

Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.

Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet "ne proces likuidimi"

Likudatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 12 Ligji i Zbatueshem**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.

**Neni 13**  
**Mosmarreveshjet**

Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

**Neni 14**  
**Ndryshimet**

Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " E 7 " Shpk hartohet ne 3 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila.

ORTAK I VETEM

Arjan Coka

